

## AKTI I THEMELIMIT

### PËR SHOQËRINË "VNA Group" SHPK

#### FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Tiranë në datën 05 Gusht 2024 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "VNA Group" shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

1. **Genc SEJKO**, i biri Hektor, i datëlindjes 10/08/1980 lindur ne Shkoder dhe banues ne Tirane, Rruga "Vace Zela", madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personal I00810064S.

#### SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria tregëtare "VNA Group" SHPK, ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në **Tiranë, Rruga Vaçe Zela, Pallati A, Hyrja 1, Ap3** me vendim të ortakëve të shoqërisë, mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

- Shoqëria Tregtare "VNA Group" SHPK, do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
- Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

#### KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 000 lekë (njqind mije lekë), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është i ndare në nje kuote me vlerë nominale 100 000 lekë (njqind mije lekë)

Kapitali themeltar zotërohet nga:

- Genc SEJKO**, zotërues i një kuote apo 100 % të kapitalit të shoqërisë me vlere 100 000 lekë (njqind mije lekë).

Kapitali fillestar nuk është paguar.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "VNA Group" shpk do të jetë :

Botimin dhe shperndarjen e gazetës "VNA", nepermjet mjeteve te ndryshme te komunikimit online.

Publikimi i gazetave, Portal Web, marketing online, publikim reklamash. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër tregtare të lejueshme që është e nevojshme dhe e dobishme për të përmbushur objektin e saj.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatëse në statut.

## ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

a- për ndryshime në statut

b- emërimin dhe shkarkimin e administratorit

c- miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.

d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit

e- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë , është **Genc Sejko** me afat 5 vjeçar me te drejtë ripërtëritje.

### **BAZA LIGJORE**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij.

Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

**ORTAKU I VETEM:**

**Genc Sejko**

GENC SEJKO  
*Gjenc*